



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE
DHE KRIZAVE

Nr. 5731 Prot.

Elbasan, më 22.5.2023

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj


KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZH

Adresa: Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd


Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit tuaj Nr.53 datë 12.05.2023 "Mbi përdorimin e fondit të emergjencave civile". Referuar V.K.M-së Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", përkatësisht në pikat ç dhe d, kapitulli III, konstatojmë pasaktësi në mënyrën e përlogaritjes së dëmit dhe pasqyrimin e vlerës financiare në vendimin tuaj.

Deri në dërgimin e dokumentacionit të saktë, akti i juaj mbetet i pakonfirmuar.

PREFEKTI
Majlinda **PERRIU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Dt.15.05.2023

Nr. 3533 prot

Nr.53 dt.12.05.2023

“Mbi përdorimin e fondit të Emergjencave Civile”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ neni 54 pika dh ,të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2021“Për Buxhetin e vitit 2022” , në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 “ Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” ,Udhezimi plotesues nr.2 date 19.01.2023 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2023”, VKM nr.414 datë 08.07.2021 “Miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes dhe te përdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile”, VKB nr. 107, datë 28.12.2022 “ Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2023-2025” , “Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 12.05.2023 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1.Të miratojë përdorimin e fondit ne vleren 237,067 leke emergjenc civile z.Tomorr Muzhaqi Bashkia Librazhd fatkeqsi natyrore(renie zjarri ne banese).

2.Fondi prej 237,067 lekë do të përballohet nga fondi i Emergjence Civile buxheti I shtetit ne stuktoren buxhetore si me poshte:

Grupi	titulli	kapitull	artikull	vlera
17	10910	01	604	237,067 leke

3.Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori Financës, Emergjencia Civile.

4.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

Sek.i Keshillit
Elson Malluta

KRYETARI I KËSHILLIT

Shetki Bahiti

